



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

VENDIM
(PROJEKT)

Nr. _____, datë _____ 2020

**“PËR
DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË
MINISTRATVE NR. 452, DATË 11.07.2012 ‘PËR LENDFILLET E MBETJEVE’”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenëve 43, pikat 6 e 7, 44, pika 3, 45 e 64 të ligjit nr. 10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, me propozimin e Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministrit për Infrastrukturën dhe Energjinë, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

Në vendimin nr.452, datë 11.07.2012 “Për lendfillet e mbetjeve”, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në Kreun XI, bëhen këto ndryshime:

a) Në pikën 25, togëfjalëshi “31 Dhejtor 2018” zëvendësohet me togëfjalëshin “31 Djetor 2022” 28 ndryshojnë si më poshtë vijon:

b) Pas pikës 25, shtohet pika 25/1, 25/2 dhe 25/3 më përmbajtjen si vijon:

“25/1 Në rast se operatorët e një venddepozitimi ekzistues hasin vështërsi dhe kanë mungesë kapacitetesh për të përgatitur planin e përmirësimit të venddepozitimit mund të kërkojnë asistencën apo bashkëpunimin e ministrisë përgjegjëse për mjedisin”.

25/2 Për venddepozitimet ekzistuese, që ndodhen në zonat e mbetjeve, operatori përgatit planin e përmirësimit për periudhen deri në përfundimin e ndërtimit të lendfillit rajonal të planifikuar apo në proces ndertimi. Plani i përmirësimit ndjek procedurat e parashikuara në kreun IX të këtij vendimi.

25/3 Planet e përmirësimit të dërguara nga operatorët për miratim pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit pas datës 31 Dhjetor 2018, miratohen nga Agjencia dhe kalojnë për shqyrtim pranë Komitetit Ndërministror për Mbetjet, në përputhje me parashikimet e këtij vendimi.”.

c) Pika 28, ndryshohet si më poshtë vijon:

“28. Agjencia Kombëtare e Mjedisit, pasi miraton planin e përmirësimit, e dërgon atë për shqyrtim pranë Komitetit Ndërmintor për Mbetjet, i cili vendos për masat që duhen marrë dhe periudhën e nevojshme të tranzicionit për zbatimin e tyre, periudhë e cila në çdo rast përfundon në datën 31 Dhjetor 2024. Plani i përmirësimit i miratuar shoqërohet edhe me një relacion shpjegues juridik dhe teknik për Sekretariatit Teknik të Komitetit, mbi pikëzimin e vendeve të vendosura si dhe impaktin mjedisor ekonomik dhe social të zonës ku ndodhet lëndfilli. Sekretariati shqyrton gjithë dokumentacionin e përcjellë nga AKM dhe i përgatit një relacion përmbledhës Komitetit.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren Zyrtare”.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

**RELACION SHPJEGUES
PËR
PROJEKTVENDIMIN**

**“PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË
MINISTRAVE NR. 452, DATË 11.07.2012 ‘PËR LENDFILLET E
MBETJEVE’”**

**I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË
ARRIHEN.**

Në kuadër të transpozimit të acquis në fushën e Mjedisit, gjatë vitit 2012, u miratua VKM nr. 452/2012 “Për lendfillet e mbetjeve”, e cila adopton Direktivën 1999/31/EC “Për lendfillet e mbetjeve”. Objekti i kësaj Direktive është të parandalojë ose të pakësojë sa më shumë të jetë e mundur efektet negative në mjedis, në veçanti ndotjen e ujërave sipërfaqësorë, ujërave nëntokësorë, tokës, ajrit dhe shëndetit të njeriut si pasojë e asgjësimit të mbetjeve të cilët duhet të përfshijnë kërkesa të rrepta teknike për mbetjet dhe lendfillet.

Direktiva për lendfillet parashikon kategoritë e ndryshme të mbetjeve (mbetje të rrezikshme, mbetje jo të rrezikshme dhe mbetje inerte) dhe zbatohet për të gjitha lendfillet, e përkufizuar si vendi i asgjësimit të mbetjeve mbi ose nëntokë.

Procesi transpozimit plotësisht të direktivave evropiane, i cili padyshim që nxitej nga vullneti i mirë për të ardhur sa më shpejt tek standardi evropian për trajtimin e mbetjeve nëpërmjet lendfillit, u realizua pa marrë parasysh koston reale të zbatimit të këtyre kritereve dhe aftësinë në kapacitete teknike apo burime njerëzore të pushtetit vendor për të realizuar atë brenda periudhës tranzitore të parashikuar në pikën 28 të kreut XI të VKM-së. Për të zbatuar plotësisht direktivën 1999/31/EC “Për lendfillet e mbetjeve” dhe për të garantuar zbatimin e detyrimeve (të munguara), projektakti parashikon zgjatjen e periudhave tranzitore si dhe futjen e një hallke të ndërmjetme të kritereve të arritshme për venddepozitimet ekzistuese.

Në mënyrë që Republika e Shqipërisë të garantojë një proces real të zbatimit të *acquis* në këtë fushë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit bëri një vlerësim mbi periudhën tranzitore të nevojshme, si dhe kriteret teknike për t'u plotësuar nga venddepozitimet ekzistuese deri në momentin e zbatimit të plotë të kriterëve të parashikuara nga *acquis* për asgjësimin e mbetjeve, gjatë vitit 2018 duke amenduar disa pika të VKM 452/2012 "Për lëndfillet e mbetjeve". Afatet e vendosura në të, nuk përputheshin me kapacitetet e qeverisë vendore për të përgatitur planet e përmirësimit në kohë. Nga ana tjetër sasia e madhe e gjenerimit të mbetjeve dhe mungesa e lëndfilleve sanitare për çdo rajon ka shkaktuar depozitim të mbetjeve në vendepozitime pa standardet e duhura mjedisore duke rritur në nivele alarmante ndotjen në vend. Nevoja për të zgjidhur situatën e menaxhimit të mbetjeve në çdo bashki, lidhur me vendosjen e kriterëve minimale në vendepozitime ekzistuese për një periudhë transitore, bën të domosdoshme propozimin e disa ndryshimeve në vendimin lidhur me lëndfillet e mbetjeve. Paraqitja e ndryshimeve për miratim do të japë mundësinë bashkive të gjejnë kapacitetet e duhura njerëzore por edhe financiare për të përgatitur në kohë planet e përmirësimit. Në rastet kur është e pamundur gjetja e financimit apo kapaciteteve, do të jetë ministria që do mbështesë njësitë vendore për të pasur planet e përmirësimit brenda afateve të propozuara.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE.

Projektvendimi nuk është i parashikuar në programin e përgjithshëm analitik të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit për vitin 2020 por është në përputhje me pikën 2.4 të Programit të Qeverisë për periudhën 2017-2021. Arsyeja e propozimit të këtij akti të paplanifikuar vjen si rezultat i afateve të ngushta të përcaktuara gjatë amendimit të kryer në vitin 2018. Bashkitë që kanë nevojë të rehabilitojnë vendepozitimet për shkak të mungesës së një impianti rajonal për trajtimin e mbetjeve, duhet patjetër të rehabilitojnë një vendepozitim me standarde minimale brenda territorit të bashkisë, për të zbutur riskun dhe reduktuar ndotjen e tokës, ajrit dhe ujrave nëntokësorë e sipërfaqësorë. Mungesa e kapaciteteve në sasi dhe cilësi në njësitë e vetqeverisjes vendore u reflektua në vonesën e përgatitjes së

planeve të përmirësimit nga njësitë e vetqeverisjes vendore dhe dorëzimit të tyre në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit. Për t'u përmendur janë dhe vonesat e shkaktuara nga zgjedhjet vendore dhe ndryshimet e stafëve në shumë prej njësive vendore. Për sa shprehet më lart, propozojmë ndryshime të afateve kohore me qëllim zbatueshmërinë e plotë të aktit.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Lendfilli i mbetjeve është opsioni më pak i preferuar, po t'i referohemi hierarkisë së menaxhimit të mbetjeve dhe duhet të kufizohet në minimumin e nevojshëm. Kur mbetjet duhet të asgjësohen nëpërmjet lendfillit, ky i fundit duhet të ndërtohet dhe të funksionojë në përputhje me kërkesat e Direktivës 1999/31/EC "Për lendfillet e mbetjeve".

Por, miratimi i këtij projektakti, i cili rrjedh si detyrim i neneve 43, pikat 6 e 7, 44, pika 3, 45 e 64 të ligjit 10463/2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", të ndryshuar, do të përmirësojë kuadrin nënligjor për menaxhimin e mbetjeve.

Ky projektakt ka si qëllim të rregullojë ato venddepozitime ekzistuese që kanë leje bashkiake, për t'i përshtatur me standardet mjedisore, duke i lënë një periudhë tranzitore. Çdo njësi e qeverisjes vendore duhet të marrë parasysh kriteret e aneksit I/I për të përmirësuar vetëm një venddepozitim brenda territorit që kanë nën juridiksion.

Me qëllim që të bëhet lehtësisht i mundur identifikimi i të gjithë efekteve negative në mjedis, si edhe të merren masat e duhura parandaluese, është e nevojshme që të përcaktohen procedurat për aplikimin dhe funksionimin e lendfillit, brenda një periudhe të specifikuar kohore (për përshtatjen e tyre edhe me Direktivën 1999/31/EC në bazë të një plani për përgatitjen dhe përshtatjen e vendit ku ndodhet lendfilli). VKM-ja në fuqi (VKM 452/2012), i ndryshuar, për t'i sjellë venddepozitimet në standardet e lendfillit për një periudhë më të shkurtër se ajo e parashikuar për vendet anëtare, ka krijuar një situatë ku pothuajse nuk ka patur

asnjë ndërhyrje me investime nga pushteti vendor për të plotësuar kriteret e aneksit I për venddepozitimet ekzistuese, kriteret të cilat i kthenin ato në venddepozitime.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR.

Në kuadër të procesit të përafrimit të legjislacionit mjedisor me *acquis*, Republika e Shqipërisë ka miratuar së pari, ligjin nr. 10463/2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar, i cili veç të tjerash, përcakton edhe kategoritë e lëndfilleve, llojet e mbetjeve që mund të asgjësohen tek secili prej lëndfilleve dhe llojet e mbetjeve që nuk mund të asgjësohen në lëndfill. Për më tepër, parashikon se çdo person që operon një lëndfill duhet të vendosë garancitë financiare, pra të disponojë të gjitha mjetet financiare që janë të domosdoshme për të mbuluar kostot e ndërtimit, operimit, mbylljes dhe kujdesit pas mbylljes së lëndfillit (periudhë e cila do të zgjasë të paktën deri në 30 vjet). Si në rastin kur personi që operon lëndfillin është njëkohësisht edhe personi garantues, ashtu edhe kur garantuesi është një palë e tretë, duhet të informojnë me shkrim Agjencinë Kombëtare të Mjedisit. Pra, projektvendimi i paraqitur është në përputhje me ligjin nr.10463/2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar. Projektvendimi, gjithashtu është në përputhje me nenin 100 të Kushtetutës.

Gjithashtu ky projektakt është në përputhje me:

- VKM nr.418, datë 27.05.2020 “Për miratimin e dokumentit të politikave strategjike dhe të planit kombëtar për menaxhimin e integruar të mbetjeve, 2020-2035”.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE).

Ky vendim nuk përafron ndonjë direktivë apo rregullore të BE-së.

Relacion shpjegues për Projektvendimin “Për disa ndryshime në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.452, datë 11.07.2012 ‘Për lëndfilllet mbetjeve’”

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT.

Projekt vendimi i propozuar ka parashikuar ndryshime të kreut XI të VKM 452/2012 “Për lendfillet e mbetjeve”, i ndryshuar. Konkretisht, nëpërmjet gjermës “a” parashikohet që operatori i një venddepozitimi ekzistues, pavarësisht nëse ka ose jo leje mjedisi, deri në datën 31 Dhjetor 2022, përgatit një plan përmirësimi të venddepozitimit dhe e paraqet atë për miratim në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit. Nëpërmjet gjermës “b” parashikohet që pas pikës 25, shtohet pika 25/1, 25/2 dhe 25/3, nëpërmjet së cilave parashikohet që:

- Në rastet kur operatorët e një venddepozitimi ekzistues, hasin vështirësi dhe kanë mungesë kapacitetesh për të përgatitur planin e përmirësimit të venddepozitimit, këto të fundit mund të kërkojnë asistencë për përgatitjen e tyre pranë ministrisë përgjegjëse për mjedisin. Ky parashikim ka si qëllim sigurimin e asistencës për operatorët me qëllim sigurimin e përfundimit të procesit sipas parashikimeve dhe brenda afateve të vëndosura në këtë vendim.

- Në zonat e mbetjeve, të cilat kanë të planifikuara ose kanë në proces ndërtimin e një lendfilli sanitar/incineratori, operatori përgatit planin e përmirësimit për rehabilitimin e një venddepozitimi për njësi të vetqeverisjes vendore. Komiteti shqyrton planin e përmirësimit pas miratimit nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit.

-Nëpërmjet pikës 25/3, synohet rregullimi i situatës së planeve të përmirësimit, të cilat për arsytet e parashtruara më lart, në përmbajtje të relacionit nuk janë paraqitur brenda afatit, duke parashikuar konkretisht që: “Planet e përmirësimit të dërguara nga operatorët për miratim pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit pas datës 31 Dhjetor 2018, miratohen nga kjo e fundit Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe kalojnë për shqyrtim pranë Komitetit Ndërmintrosor për Mbetjet, në përputhje me parashikimet e këtij vendimi”.

Në vijim, nëpërmjet gjermës “c” të projektaktit ndryshues, parashikohet ndryshimi i pikës 28, të aktit bazë, duke përcaktuar: Agjencia Kombëtare e Mjedisit, pasi miraton planin e përmirësimit, e dërgon atë për shqyrtim pranë Komitetit Ndërmintrosor për Mbetjet, i cili vendos për masat që duhen marrë dhe periudhën e nevojshme të tranzicionit për zbatimin e tyre, periudhë e cila në çdo rast përfundon në datën 31 Dhjetor 2024. Plani i përmirësimit i miratuar shoqërohet edhe me një

relacion shpjegues juridik dhe teknik për Sekretariatit Teknik të Komitetit, mbi pikëzimin e venddepozitimit si dhe impaktin mjedisor ekonomik dhe social të zonës ku ndodhet lëndfilli. Sekretariati shqyrton gjithë dokumentacionin e përcjellë nga AKM dhe i përgatit një relacion përmbledhës Komitetit.

Ndryshimet e tjera në këtë paragraf përjashtojnë venddepozitimet ekzistuese nga detyrimi për të plotësuar kriteret e përcaktuara në aneksin I, me kushtin që ato të plotësojnë kriteret e kërkuara në aneksin I/I, pjesë e Planit të Përmirësimit, deri në datën 31 Dhjetor 2024.

Një periudhë kalimtare parashikohet edhe për ato bashki të cilat kanë dorëzuar pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, planet e përmirësimit por ende nuk kanë një vendim të komitetit të miratuar.

Ky përjashtim është bërë me qëllim që të bëhet lehtësisht i mundur identifikimi i të gjithë efekteve negative në mjedis, si edhe të merren masat e duhura parandaluese, është e nevojshme që të përcaktohen procedurat për aplikimin dhe funksionimin e lëndfillit, brenda një periudhe të specifikuar kohore (për përshtatjen e tyre edhe me Direktivën 1999/31/EC në bazë të një plani për përgatitjen dhe përshtatjen e vendit ku ndodhet lëndfilli). VKM-ja në fuqi (VKM 452/2012), i ndryshuar, për t'i sjellë venddepozitimet në standardet e lëndfillit për një periudhë më të shkurtër se ajo e parashikuar për vendet anëtare, ka krijuar një situatë ku pothuajse nuk ka patur asnjë ndërhyrje me investime nga pushteti vendor për të plotësuar kriteret e aneksit I për venddepozitimet ekzistuese, kriteret të cilat i kthenin ato në venddepozitime.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKT VENDIMIT

Për zbatimin e këtij projekt vendimi ngarkohen:

1. Ministria Turizmit dhe Mjedisit;
2. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;
3. Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKT VENDIMIT

Për hartimin e këtij projekt vendimi kanë kontribuar:

-Strukturat përgjegjëse në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit.

Projektvendimi është me bashkëfirmosje me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë. Drafti i propozuar do të dërgohet për mendim në Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, si edhe në Agjencinë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE.

Ky projektvendim nuk përcakton shpenzime shtesë buxhetore, pasi strukturat që do të angazhohen për zbatimin e këtij vendimi, janë aktualisht të ngritura dhe funksionale.

MINISTËR

Belinda BALLUKU

